

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**

Nr. 6680 prot.

Tiranë, më 26, 7, 2022

**NJOFTIM**

Në mbështetje të Ligjit nr.26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”; Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” (i ndryshuar), Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundravajtjet administrative”; VKB nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”; Inspektorati i Mbrojtjes të Territorit pranë Bashkia Tiranë për të vijuar me procesin e vënies në ekzekutim të vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Tiranë “Për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit”, në funksion të mbledhjes të dënimeve administrative (gjoba) të vendosura nga IMT Bashkia Tiranë, ju fton të shprehni interesin tuaj për të bashkëpunuar në kuadër ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Kërkesa për shprehje të interesit duhet të shoqërohet me dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Liçenca për veprimtarinë profesionale lëshuar nga Ministri i Drejtësisë (kopje të noterizuar).
- NIPT-i (kopje e noterizuar).
- Ekstrakt Historik i lëshuar nga QKB (origjinal ose kopje e noterizuar).
- Vërtetim që ka paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore sipas afateve të parashikuara në legjislacionin tatimor. (origjinal ose kopje e noterizuar ne 3-mujorin e fundit).
- Vërtetim që ka paguar detyrimet pranë OSHE dhe UKT.
- Currículum vitae e shoqërisë përmbarimore ose e përmbaruesit gjyqsore.
- Vërtetim nga Ministria e Drejtësisë që nuk ka masë disiplinore dhënë sipas nenit 52 të Ligjit Nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” (ndryshuar me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009 dhe ligjin nr.36/2012) (origjinal ose kopje e noterizuar ne 3-mujorin e fundit);

Deklarata nga kreditorët (institucionet) për zbatimin e kontratave për ekzekutimin e titujve në tre vitet e fundit (origjinal ose kopje e noterizuar ne 3-mujorin e fundit).

**KRYEINSPEKTORI**

**Mariglen QATO**

Shënim: Ky njoftim do të shpallet në stedën e IMT menjëherë.